

PËR: Z. NAIM QELAJ, AVOKAT I POPULLIT

NGA: SHOQATA E KONTABILISTËVE TË ÇERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE TË KOSOVËS (SHKÇAK)

LËNDA: REAGIM PUBLIK NDAJ RAPORTIT NR. 441 / 2021 TË DATËS 29/04/2022 TË AVOKATIT TË POPULLIT LIDHUR ME NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT NR. 06/L-32 PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM

PËR SHKELJE TË NENIT 3.1 (PARIMET BAZË TË VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT) DHE NENIT 16.4 TË LIGJIT NR. 05/L-019 PËR AVOKATIN E POPULLIT

DATA: 14/09/2022

I nderuar Z. Qelaj,

Në vazhden e komunikimeve që Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (në vijim "SHKÇAK") ka pasur me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (në vijim "KKRF") lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në proces të licencimit të shoqatave profesionale të cilat anëtarësojnë kontabilistët dhe auditorët në Kosovë, në mënyrë të barabartë për të gjitha shoqatat profesionale, në vëmendje të SHKÇAK është sjellë një Raport i Avokatit të Popullit nr. 441/2021 i datës 29/04/2022 lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim.

SHKÇAK nuk ka qenë në dijeni për përfshirjen e Avokatit të Popullit në çështjen e vlerësimit të dispozitave të Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

I. Lidhur me faktet dhe rrethanat e rastit

1. SHKÇAK është njëra nga 3 shoqatat profesionale që veprojnë në Kosovë, e cila anëtarëson aktualisht 1413 anëtarë. SHKÇAK ka plotësuar kërkesat ligjore për mbajtje / vazhdim të licencës së operimit në pajtim me dispozitat e nenit 3, paragrafi 1.13 lidhur me nenin 33, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, dispozita këto që ju i keni trajtuar në Raportin tuaj.
2. Të indinjuar veçanërisht me mënyrën se si keni paragjykuar mbi statusin e SHKÇAK – si shoqatë profesionale, në raport me shoqatat tjera, në formulimin e pikës 40 të Raportit tuaj dhe krahas faktit që si shoqata me numrin më të madh të anëtarësisë, e licencuar pranë KKRF - së asnjëherë nuk është kontaktuar për çështjen e trajtuar nga ju, ne bëjmë këtë Reagim publik përmes të cilit do të shpalojmë edhe arsyet e indinjatës tonë me ju si institucion, sipas ligjit, i pavarur dhe do të shpalojmë edhe leximin tonë të dispozitave kushtetuese të cilave ju i jeni referuar gjatë trajtimit të dispozitave të Ligjit për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim në kontekstin e arsyeimeve që keni dhënë në Raport.



Fillimisht, vlerësojmë se Raporti juaj është përpiluar në kundërshtim me parimin udhëheqës të punës juaj të përcaktuar me nenin 3.1. të Ligjit për Avokatin e Popullit.

3. Neni 3. 1 i Ligjit për Avokatin e Popullit parasheh se: Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

4. Parashtrimin e mësipërm e argumentojmë me faktin se ju asnjëherë nuk keni kontaktuar me asnjë zyrtar të SHKÇAK –ut përballë faktit se SHKÇAK është shoqatë profesionale me numrin më të madh të anëtarëve , për të marr sqarime , një opinion apo çfarëdo dokumentacioni nga kjo Shoqatë lidhur me çështjen e trajtuar dhe sidomos kur SHKÇAK etiketohet në Raportin tuaj si “shoqatë e privilegjuar” dhe paragjykohet për mundësi vendimesh arbitrare apo krijim raportesh varësie në dëm të shoqatave tjera.

5. Duke qenë një institucion i pavarur, sipas ligjit, është brengosëse mënyra se si e keni arsyetuar çështjen e trajtuar, në tërë Raportin përgjithësisht, por me theks të veçantë në pikën 40 të Raportit tuaj, pa një hetim të plotë sipas detyrimit ligjor nga neni 16. 4 i Ligjit për Avokatin e Popullit, tek të gjitha shoqatat profesionale që janë palë të interesit dhe me emërtim i keni përfshirë në Raportin tuaj.

6. Mënyrë e prezantimit të shoqatave në Raportin tuaj , me theks të SHKÇAK-ut që e quani shoqatë të privilegjuar, pa e kontaktuar ndonjëherë, neve na indikon një mungesë paanësie dhe pavarësie në çasjen tuaj në vlerësimin e një çështje aq serioze që adreson kërkesat ligjore të miratuara nga Kuvendi i Kosovës me qëllim të ngritjes dhe ruajtjes së nivelit profesional të shoqatave të cilat licencojnë kontabiliste dhe auditorë, qoftë ata që ofrojnë shërbimet e tyre në sektorin privat apo në sektorin publik, e rrjedhimisht edhe të vetë profesionit të kontabilistit dhe auditorit në Kosovë.

7. Nuk kuptojmë, i nderuar Z. Qelaj mbi çfarë baze dhe mbi cilin hetim mbështeteni kur na etiketoni si shoqatë e privilegjuar, kur na paragjykoni për vendime arbitrare dhe për vendosje të shoqatave tjera në pozitë të pabarabartë apo në pozitë varësie (*pika 40 e Raportit tuaj*) !

8. Nuk kuptojmë poashtu kush i trajton në mënyrë më pak të favorshme shoqatat të cilat nuk janë anëtare të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (në vijim FNK) (*pika 42 e Raportit tuaj*)!

9. SHKÇAK në mënyrë vullnetare, për qëllime të ngritjes së standardeve profesionale të anëtarësisë së saj dhe me një politikë rigoroze dhe të disiplinuar të harmonizimit dhe zbatimit të standardeve të profesionit, përmes cilësisë së trajtimeve të ofruara, kontrolleve të cilësisë së performancës së profesionistëve, procedurave për disiplinim, kontributit të vazhdueshëm në avancimin e interesit publik në sferën e kontabilitetit dhe auditimit , qeverisjes së vet Shoqatës sipas standardeve më të larta të qeverisjes, ka arritur të anëtarësohet në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve në vitin 2009.

10. Statusin e anëtarit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (në vijim “FNK”), SHKÇAK, me të njëjtin përkushtim profesional si në kohën e anëtarësimit, duhet edhe ta mbajë. Për dijeninë tuaj, të qenit anëtar në Federatë Ndërkombëtare jo vetëm që konsumon kohë dhe energji, por ka edhe një kosto të konsiderueshme që përkthehet në cilësinë e trajtimeve të anëtarësisë, të ngritjes së standardeve profesionale, të mbikëqyrës së cilësisë dhe një mori aktiviteteve tjera që ofrohen për anëtarët e SHKÇAK në mënyrë që të njëjtët dhe Shoqata bashkë me ta të jenë në nivel me të gjitha organizatat tjera simotra të anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve. Siç ka kritere për anëtarësim në FNK, ka edhe kritere edhe për ruajtjen e statusit të anëtarit.

11. Ruajtja e statusit të anëtarët në FNK, SHKÇAK-ut ju ka imponuar nga kërkesa ligjore e nenit 3, paragrafi 1.13 lidhur me nenin 33, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim.

12. Sikur t’i çaseshit me paanësi dhe me një hetim të plotë për çështjen e trajtuar, do të gjenit se:

- IKAF është licencuar nga KKRF që në vitin 2013, dmth disa vite para miratimit të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim;
- IKAF ka ngritur çështjen e dispozitave ligjore lidhur me kërkesën për anëtarësim në Federatë Ndërkombëtare tek ju, si Avokat i Popullit, pak kohë para skadimit të afatit ligjor për anëtarësim në FNK, për shkak të mosarritjes së plotësisë të kriterëve dhe standardeve për anëtarësim në këtë Federatë ndërkombëtare.
- IKAF, me vet-iniciativë, qysh në vitin 2015 i është drejtuar FNK-së me kërkesë për fillimin e procesit të anëtarësimit në Federatë.
- SHKÇAK iu është përgjigjur kërkesës së dy shoqatave profesionale - IKAF dhe IAAB për t’i sponsoruar në procesin e anëtarësimit në FNK dhe brenda afateve ligjore.
- Për qëllime të transparencës dhe eliminimit të çdo dyshimi në subjektivitet gjatë procesit të sponsorizimit dhe për sigurimin e profesionalizimit të nivelit më të lartë në proces sponsorizimi SHKÇAK ka kërkuar angazhimin e ekspertëve ndërkombëtare të lëmisë. Janë angazhuar ekspertë nga ROYAL NBA Holanda, me pëlqimin edhe të IKAF.
- FNK është njoftuar me procesin dhe është pajtuar me fillimin e procesin të “Due diligence”.
- IKAF nuk ka bashkëpunuar në kërkesat për dorëzim të dokumentacionit të kërkuar sipas standardeve të FNK-së . Procesi me IKAF ka ngecur për arsye të panjohura për ne.
- IAAB ka shprehur interesim për anëtarësim në FNK gjatë vitit 2021. SHKÇAK është duke vazhduar procesin e “due diligence” në IAAB.

II. Lidhur me analizën ligjore

13. Theksi i arsytimit të Raportit tuaj mbështetet në parimin e diskriminimit.

14. Ju thirreni në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që parasheh:

- *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”*

15. Në raport me parimin e diskriminimit ne vërejmë një çasje jo konsistente, të pambështetur mbi fakte dhe kundërthënëse në interpretimet.

16. Nuk mund të pajtohem me analizën tuaj se dispozitat e nenit 3 paragrafi 1.13 lidhur me nenin 33, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim janë në kundërshtim me këtë dispozitë kushtetuese për parimet e rendit kushtetues.

17. Barazia dhe jo diskriminimi nuk qëndron vetëm në raport me të drejtat dhe liritë por edhe në raport me detyrimet e përcaktuara me ligj për palët.

18. Dispozita e nenit 3, paragrafi 1.13. e Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim më sipër, nuk nënkupton vetëm anëtarësimin në FNK, por edhe ruajtjen / vazhdimësinë e këtij anëtarësimi. Anëtarësimi nuk është një veprim i vetëm, por është proces në vazhdimësi. Kjo dispozitë është e zbatueshme jo vetëm për shoqatat të cilat të duhet të anëtarësohen në FNK, por dhe ato të cilat janë anëtarësuar e duhet ta të mbajnë/ vazhdojnë anëtarësimin në FNK. Në këtë kontekst, asnjë shoqatë profesionale e cila duhet licencuar pranë KKRF-së nuk është e privilegjuar në raport me tjetrën. Detyrimi i anëtarësimit në FNK nuk është selektiv, por vlen për të gjitha shoqatat profesionale që janë të licencuara, apo që do të licencohen nga KKRF.

19. Përkundër arsytimeve nga Raporti juaj, ne gjejmë më diskriminues faktin që një Shoqatë, në zbatim të ligjshmërisë, plotëson të gjithë kërkesat ligjore për t'u kualifikuar për licencim nga KKRF duke ruajtur statusin e anëtarit në FNK (me gjithë koston e kësaj anëtarësie dhe rrezikun e humbjes së anëtarësisë së saj për shkak të kërkesave rigoroze të kualifikimit profesional) kurse shoqata/ t tjera mëtohet të amnistohen nga ky detyrim, pas skadimit të afatit për përmbushjen e detyrimit ligjor për licencim pranë KKRF-së.

20. Ju thirreni në nenin 44 të Kushtetutës së Kosovës që përcakton:

- *“Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.”*

21. Nëse sipas analizës suaj ligjore , kërkesa për anëtarësim në FNK e përcaktuar me nenin 3.1.13 të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim paraqet shkelje të kësaj dispozite kushtetuese, ju duhet të ishit deklaruar edhe për kërkesat ligjore për anëtarësim në shoqata profesionale, sipas nenit 29 dhe 30 të Ligjit, si parakusht për çertifikim / licencim për ushtrim të profesionit të kontabilistit / auditorit. Nuk mund të zbatohet parimi i njëjtë, i lirisë së asociimit , në mënyrë të ndryshme lidhur me kërkesën ligjore për anëtarësim.

22. Ju thirreni në nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës që përcakton :

- *"1. E drejta e punës garantohej.*
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës. Lidhur me këtë dispozitë, arsyetoni se anëtarët të cilët nuk janë anëtarë të FNK-së do t'u merrej licenca dhe automatikisht kjo do të sjellje revokim të licencave të anëtarëve të tyre dhe pamundësi për të ushtruar profesionin "

23. Dispozita ligjore që përcakton revokimin e licencës për shoqatat profesionale të papërgjegjshme, res. që nuk respektojnë kërkesat ligjore për licencim, nuk nënkupton edhe revokim të licencës për ushtrim të profesionit. Nuk qëndron fakti se kontabilistëve dhe auditorëve të një shoqate profesionale të përfshirë në shkelje të ligjit për mos përmbushje të kërkesave ligjore për licencim do t'u pamundësohet ushtrimi i profesionit. Anëtarët e atyre shoqatave që veprojnë në shkelje të ligjit gjithnjë kanë opsionin e anëtarësimit në Shoqatë/ a që kanë licencën apo janë në proces të sigurimit të licencës, brenda afateve ligjore, duke përmbushur kështu kërkesën ligjore për anëtarësim në FNK.

24. Poashtu, Shoqatat që nuk kanë arritur të licencohen në Federatë ndërkombëtare nuk nënkupton se do të shuajnë aktivitetin e tyre. Shoqatat sigurisht se mund të vazhdojnë aktivitetin dhe të kanë anëtarësi, por jo për qëllime të licencimit dhe çertifikimit në KRFF. Të njëjtat si qendra trajnuese dhe OJQ me anëtarësi mund të vazhdojnë aktivitetet dhe të akreditohen në AKK, por jo për qëllime të Ligjit nr. 06/L-32 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim

III. Lidhur me Direktivat Evropiane

25. Sigurisht se sipas Direktivave të BE-së nuk do kërkohej asociimi në federatë ndërkombëtare i shoqatave profesionale, dhe për këtë çështje vendoset me legjislacioneve nacionale nga ligjvënësit, në varësi të nivelit dhe nevojave të zhvillimit të profesionit të kontabilistit / auditorit në atë shoqëri dhe rrethanave tjera të ndërlidhura me sundimin e ligjit. Kjo për faktin se shkalla e zhvillimit të standardeve profesionale, të cilësisë së kontrollit të ushtrimit të profesionit, në BE, janë të arritura sa që nuk kërkohej edhe një ndihmë tjetër nga një forum ndërkombëtar që të vihen në binarë rregullat e profesionit. Së dyti, vetëdijesimi i shoqatave në shtetet anëtare të BE-së është aq i lartë sa që anëtarësimi në federata ndërkombëtare bëhet vullnetarisht dhe në masë të madhe, meqë shoqatat janë të vetëdijesuar se vetëm me një bashkëpunim më të gjerë, rajonal etj, mund të bëhet harmonizimi i standardeve të kontabilitetit dhe auditimit e që është në shërbim të qarkullimit më të mirë dhe me të lehtë të mallrave dhe shërbimeve.

26. Sponzorizimi nga një shoqatë profesionale vendore, anëtare e FNK-së, që ju e përmendi në Raportin tuaj pa një hetim të detajuar të procesit, nuk bëhet sipas tekeve të asaj shoqate anëtare cilado qoftë ajo, por sipas rregullave dhe udhëzimeve strikte që ipen nga FNK-ja e cila njëherit mbikëqyr procesin përmes komunikimeve të vazhdueshme të palëve në procedurë.

IV. Përfundim

27. Për të përmbyllur, Raporti juaj është përpiluar në anashkalim të argumenteve të të gjitha palëve të interesit, në etiketim të pa bazë të shoqatave që veprojnë në përputhje me ligjin dhe në përpjekje për të amnistuar atë/o shoqata që nuk respektojnë, jo vetëm detyrimet ligjore ndaj autoritetit licencues por as detyrimet ndaj anëtarëve të tyre të cilët ua kanë besuar shoqatave plotësimin e kërkesave administrative ligjore për qëllime të ushtrimit të profesionit .

Në emër të SHKÇAK:

Nazmi Pllana

Kryetar i Bordit të SHKÇAK

